

PEZULLIMI I LEJES SË DREJTIMIT

Pezullimi i lejes së drejtimit bëhet nga organet e policisë në rast të shkeljeve të normave të qarkullimit.

Ai bëhet sipas rasteve të mëposhtme:

-ai që **drejton** një mjet për të cilin duhet një **leje drejtimi e ndryshme nga ajo që zotëron** ose drejton një mjet të shërbimit publik i pajisur me leje drejtimi por jo me çertifikatë aftësie profesionale, kur kjo kërkohet, dënohet me gjobë si dhe masë administrative plotësuese të pezullimit të lejes së drejtimit 6-12 muaj;

-në rast **humbje të përkohshme të aftësive fizike dhe psiqike** (pezullim në kohë të papërcaktuar deri në rifitim e aftësive);

-kur **tejkalohe** me më shumë se **20 km/orë kufiri maksimal i shpejtësisë** ndëshkimi është me gjobë si dhe merret masa administrative plotësuese e pezullimit të lejes së drejtimit nga 1-3 muaj. Në qoftë se shkelja është kryer nga një drejtues mjeti që e zotëron leje drejtimit prej më pak se 3 vjetësh, pezullimi bëhet 3-6 muaj; kur zotëruesi i lejes së drejtimit përsërit brenda një viti shkeljen e tejkalimit të shpejtësisë me më shumë se 20 km/orë, merret masa administrative plotësuese e pezullimit të leje drejtimit nga 4-12 muaj;

-kur qarkullohet në kundravajtje në **kthesa, kurrize** apo në ndonjë rast me **fushëpamje të kufizuar** ndëshkimi është me gjobë si dhe pezullim të lejes së drejtimit 2-6 muaj; kur shkelja përsëritet pezullimi bëhet 4-12 muaj;

-në **autostrada dhe në rrugë interurbane kryesore, ndryshimi i sensit të lëvizjes, kapërcimi i trafikndarësit si dhe qarkullimi në sens të kundërt**, ndëshkohen me gjobë si dhe merret masa administrative plotësuese e pezullimit të leje drejtimit nga 12-24 muaj;

-kur qarkullohet në korsinë e emergjencës përveç se kur ndalohet apo rifillohet lëvizja si dhe qarkullimi në korsite e shpejtimit apo të ngadalësimit përveç se kur hyhet apo dilet nga karrexhata ndëshkohet me gjobë si dhe merret masa administrative plotësuese e pezullimit të leje drejtimit nga 6-12 muaj;

-kur **drejtohet mjeti nën ndikimin e pijeve alkolike** ndëshkimi është me gjobë si dhe pezullim të leje drejtimit nga 6-12 muaj; kur veprimi përsëritet brenda një viti merret masa e pezullimit të leje drejtimit nga 12-24 muaj;

-kur **kryhet aksident me pasojë dëme materiale dhe nuk ndalohet**, bëhet pezullimi i lejes së drejtimit nga 6-12 muaj; kur kryhet aksident me dëmtime në njerëz dhe nuk zbatohet detyrimi i ndalimit, atëherë pezullohet leja e drejtimit 12-24 muaj dhe dënohet sipas kodit penal;

-kur **shkelen rregullat e ndalim parakalimit** ndëshkimi është me gjobë; kur veprimi përsëritet brenda 2 vjetësh bëhet pezullimi i lejes së drejtimit nga 3-6 muaj;

-kur si pasojë e **mosrespektimit të distancës së sigurisë** ndodh një përplasje me dëmtime të rënda për mjetin, ndëshkimi është me gjobë; kur i njëjti veprim përsëritet brenda 12 muajve të paktën 2 herë, atëherë në shkeljen e fundit zbatohet masa plotësuese e pezullimit të leje drejtimit nga 12-24 muaj;

-kur **nuk ndalohet në postbllloqe të policisë rrugore dhe ushtarake**(kur nuk përbën vepër penale),ndëshkimi është me gjobë si dhe masë plotësuese pezullimi i lejes së drejtimit për 12 muaj;

-kur **shkelen rregullat e dhënies së përparësisë,nuk zbatohet sinjalizimi dhe vazhdohet lëvizja kur semaforiose polici e ndalojnë,nuk zbatohen rregullat për kalimin në nivel,kur me autotren,artikular ose gjysëmrimorkiator nuk respektohet ndalim-parakalimi**,ndëshkimi është me gjobë;në rast se veprimipërsëritet të paktën 2 herë brenda 12 muajve atëherë bëhet pezullimi i leje drejtimit nga 6-12 muaj;

-kur qarkullohet me mjet që,përfshirë dhe ngarkesën,kalon kufijtë e përmasës dhe të masës ndëshkimi është me gjobë si dhe pezullim të leje drejtimit nga 1-2 muaj.